



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.10.2024

Nr: 187

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 2 ID NGA KOALICIONIN PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA (KRIIK), NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024"

Sot më datë 08.10.2024 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Zj. Haide Dhuli, Drejtor i Shkollës së Mësmeve të Bashkuara "Qazim Pali", Borsh;
Z. Vangjel Tavo, Kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Himarë;
Blendi Klosi, përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe pika 2, neneve 91, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pika 2, të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Nr: 187

Data: 08.10.2024

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024"

KONSTATOJ:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me shkresën nr. 2335 më datë 02.08.2024 nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) . Nëpërmjet këtij denoncimi të regjistruar nga KQZ me nr. 2 ID, pretendohet si më poshtë vijon:

“Në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, KRIIK po monitoron nga afër gjithë procesin e përgatitjes së tyre, si dhe fushatën elektorale të subjekteve garuese.

Në funksion të fushatës së tij elektorale, kandidati i Partisë Socialiste për kryetar bashkie, z. Vangjel Tavo si dhe përfaqësues të kësaj partie, kanë zhvilluar në datën 01.08.2024, një takim elektorale, në Borsh, në oborrin e shkollës së Mesme e Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh. Ky takim është postuar nga kandidati në faqen e tij zyrtare në Facebook, e shoqëruar me shkrimin:

“Një takim tejet i përzemërt në Borshin e bukur, me histori të pasur, me monumente kulturore historike dhe me banorë mikpritës e punëtorë. Ndihej i nderuar që banorët vendosin besimin e tyre te mua, e ndajnë me mua shqetësimet dhe problemet që hasin çdo ditë. Besimi i Tyre më bën edhe më të përkushtuar që pas 4 gushtit të punoj për zgjidhje sa më të shpejta të çështjeve që e shqetësojnë komunitetin. Fjala ime sot është një premtim i mbajtur nesër. Është një kontratë publike në përmbushjen e të gjitha premtimeve pas 4 gushtit. Sepse të dielën nuk ka thjesht ZGJEDHJE por është dita kur nis ZGJIDHJA për të gjitha shqetësimet dhe nevojat e banorëve, Vangjel Tavo #1.

Nga këqyrja e fotografive të postuara mbi këtë takim elektorale është zhvilluar në oborrin e shkollës.”

Bazuar në sa më sipër neni 19 pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhje i Republikës së Shqipërisë”, i udhëzuar përcakton kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në mbështetje të përcaktimit të nenit 8, pika 1, “a” dhe “b” të vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, KSHZ filloi hetimin administrativ.

Sa më sipër Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës nr. 2342 prot., datë 02.08.2024 me lëndë “Kërkesë për Informacion”, i ka kërkuar z. Vangjel Tavo dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, informacion të detajuar për sa kërkohet në denoncimet me objekt “Parregullsi zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme në bashkinë Himarë.”

Në vijim nga administrata e KQZ-së, shkresa e sipërcituar, u është dërguar palëve edhe nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 8.2.2024, ora 19:16 me objekt “Kërkesë për informacion”.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar kthimi i përgjigjeve si më poshtë vijon:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 2342/1 prot. më datës 8.8.2024, Zyra Vendore e Arsimit Para Universitar Vlorë-Himarë, bën me dije se:

Bazuar në nenin 91 pika 2, sqarojmë se procesi mësimor për vitin shkollor 2023-2024 ka përfunduar në datën 14.06.2024, çka tregon se në datën 01.08.2024 institucioni arsimor nuk

Nr: 187

Data: 08.10.2024

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”

funksionon si institucion mësime të mësuara. Në këtë rast nuk kemi përdorim të detyruar të burimeve njerëzore brenda orarit të punës dhe as gjatë orarit mësimor, pra nuk kemi cënim të procesit mësimor pasi shkolla ka përfunduar. Stafit mësimor të institucionit arsimor "Shkolla e mesme e bashkuar: Borsh është në periudh pushimesh dhe ZVAP Vlorë-Himarë nuk ka asnjë ndikim të këta punonjës.

Theksojmë gjithashtu se takimi është zhvilluar në ambientet e jashtme të institucionit arsimor "Shkolla e mesme e bashkuar" Borsh (oborri i shkollës) dhe jo në mjediset e brendshme të saj.

Godina e institucionit arsimor parauniversitar "Shkolla e mesme e Bashkuar" Borsh është në administrim të Bashkisë Himarë dhe jo nën administrimin e ZVAP Vlorë-Himarë."

2. Njëpërmjet shkresës me nr. 2342/2 prot më datës 13.8.2024, z. Vangjel Tavo, bën me dije se:

Në përgjigje të kërkesës tuaj transmetuar me shkresë nr. 2342, date 02.08.2024, sa i përket denoncimit (burim informacioni rrjeti social Facebook, adresë personale, foto ku është publikuar një aktivitet elektorale në ambientet e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Qazim Pali", Borsh paraqitur nga Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), administruar pranë jush njëpërmjet postës elektronike në datë 02.08.2024, ju bëj me dije sa vijon:

Në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme të datës 04.08.2024 për Kryetarin e Bashkisë Himarë, kam kandiduar si përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë, tashmë fitues i kësaj gare, fakt i njohur publikisht, çertifikuar dhe nga ana juaj si institucioni kompetent.

Referuar shkresës tuaj, bëhem me dije se sipas denoncimit nga (KRIIK) se ka shkelje të parashikuar të nenit 91 dhe 169 të ligjit nr. 10 019 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, pasi pretendohet se janë keqpërdorur burime të enteve publike.

Këto pretendime nga ana e denoncuesit bazohen në fotot e marra nga profili im në facebook, duke qënë se në datë 01.08.2024 është zhvilluar takim elektorale në ambientet e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Qazim Pali", Borsh, ku ndër të tjera referohet se kanë qënë të pranishëm dhe Z. Blendi Klosi si përfaqësues i PSSH dhe drejtori i kësaj shkolle.

Sa i përket rastit konkret, vlerësoj se si në raport me parashikimet e "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar ashtu dhe Kodit Civil, në rastet e burimeve të sistemit shkollor parauniversitar, nuk gjendemi para përdorimit të këtyre burimeve, pasi:

a) Siç dhe mund të konstatohet nga fotot, aktiviteti nuk është zhvilluar brenda ambienteve (nuk janë përdorur, klasa, zyra, nuk është kaluar dera e shkollës) të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Qazim Pali", Borsh.

b) Specifikimi që ligjvënësi i ka dhënë burimit, në parashikimet e pikës 2 të nenit 92 në harmoni me nenin 142 të Kodit Civil sanksionon qartë se "burimi për rastin në fjalë është sendi i paluajtshëm, ndërtesa e lidhur me tokën, e trupëzuar me të në mënyrë të qëndrueshme". Jo rastësisht, ligjvënësi ka specifikuar këtë detaj, për të vendosur kushtin se ku fillon përdorimi i "burimit", duke lidhur burimin me ndërtesën, e në rastin në fjalë, përdorimin e ambienteve të ndërtesës, shkollës për rastin konkret (gjë që nuk ka ndodhur).

c) Nga ana tjetër, nëse i referohemi nenit 93 të ligjit nr. 10 019 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nga ligjvënësi kemi shpjegim direkt të kuptimit se çfarë quhet përdorim i burimeve/ndërtesave publike, në harmoni me sqarimet sa më lartë përmendur. Konkretisht në këtë dispozitë sanksionohet se:

Nr: 187

Data: 08.10.2024

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024"

"1. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave, për aq sa është e mundur, krijohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë.

2. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen:

a) në ndërtesa private, pa vendim të KQZ-së. Në çdo rast qendra e votimit nuk mund të caktohet në banesa private;

b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore;

Sa i përket kësaj dispozite, vetë procesi i votimit organizuar nga KQZ, mes përjashtimeve se ku nuk mund të organizohet qendrat e votimit, ka përjashtuar institucionet arsimore, fakt i mirënjohur ku organizohet votimi në përgjithësi në Shqipëri. Pra dhe nëse marrim përdorimin e këtyre burimeve, lidhet me përdorimin e ambjenteve të brëndshme të institucionit arsimor dhe jo në një ambient të jashtëm apo rreth tij.

d) Nga ana tjetër, nëse do të përdornim logjikën juridike të përdorur nga denoncuesi, çdo evenimet (proteste, takim apo çdo natyrë tjetër organizimi), që mund të organizohet nga OJF, apo organizime politike para Kryeministrit, apo çfarëdo institucioni tjetër publik, qendror apo vendor, do të thotë përdorim të burimeve publike të institucionit ?!!!!

e) Sa i përket pjesës së pretendimeve se ka përdorim të burimeve njerëzore, ku relatohet prezenca e Z. Blendo Klosi dhe drejtorit të shkollës, diskutimi juridik është i qartë dhe parashikohet në pikën 2 të nenit 91, paragrafi ku sanksionohet se "Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore." Për rastin në fjalë nuk jemi as në kushtet brenda orarit të punës dhe as brenda orarit mësimor, pasi shkollat kanë perfunduar punën për vitin 2023-2024 (janë mbyllur), pra nuk jemi para përdorimit të burimeve njerëzore. Sa i përket prezencës së Z. Blendi Klosi dhe drejtorit të shkollës, përpos axhendes politike që mund të ketë Z. Klosi, për të dyja këto raste, bindja politike, pjesmarrja në evenimente, e drejta e votës janë të drejta që sanksionohen dhe mbrohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

3. Nëpërmjet shkresës me nr. 2417/1 prot. më datës 15.8.2024, Zyra Vendore e Arsimit Para Universitar Vlorë-Himarë, bën me dije se:

Bazuar në kërkesën tuaj me nr 2417 Prot, date 09.08.2024 , protokolluar me tonën me nr 1374 Prot, datë 12.08.2024, nëpërmjet të cilës ju kërkoni informacion , ju bëjmë me dije se:

- 1- Drejtues i institucionit arsimor Shkolla e Mesme e Bashkuar "Qazim Pali" Borsh është znj. Haide Dhuli.
- 2- Adresa e postës elektronike është : shkollaqazimpali@hotmail.com
- 3- Adresa e plote e institucionit arsimor është : Lagjja "Ixuar" Borsh, Vlorë.

Nëpërmjet postës elektronike e-mail më datë 04.10.2024 në adresën shkollaqazimpali@hotmail.com, është njoftuar zj. Haide Dhuli për seancën e datës 08.10.2024, ora 12:00. Gjithashtu bashkëlidhur i është dërguar dhe relacioni shpjegues për sa pretendohet në

Nr: 187

Data: 08.10.2024

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024"

denoncimin nr. 2 ID. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk ka administruar asnjë përgjigje nga zj. Dhuli.

Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve:

- provohet se veprimtaria me karakter elektoral është kryer në ambientet e jashtme të institucioneve publike, konkretisht në ambjentet rrethuese të shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh, të paaksesueshme nga publiku i gjerë;
- vërtetohet se në këtë takime ka patur deklarime, thënie elektorale dhe thirrje për mbështetje të kandidatit për kryetar bashkie;
- provohet se në favor të kandidatit për kryetar në bashkinë Himarë, me zhvillimin e fushatës elektroale në ambientet e shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh janë vendosur burime publike në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore.
- provohet se drejtori i shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh zj. Haide Dhuli, ka vënë në dispozicion të kandidatit për kryetar bashkie, ambientet e shkollës për qëllime zgjedhore.

Neni 91, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.” Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9, në nenin 3, pika 1.3/c, qartësisht ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.

Sa referohet më lart, në vijim konkudoj se:

- Drejtori shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh, zj Haide Dhuli, ka vënë në favor të kandidatit për kryetar bashkie, ambientet e jashtme të shkollës, për qëllime zgjedhore, në shkelje të nenit 91, pika 1 dhe pika 2, të Kodit Zgjedhor. Për këtë shkelje neni 171, pika 1 i Kodit Zgjedhor parashikon sanksion administrativ në masën 3000 deri 90 000 mijë lekë.
- Kandidati për kryetar të bashkisë, në cilësinë e subjektit zgjedhor, ka kryer kundërvajtje administrative, pasi në mbështetje dhe favor të tij janë vënë dhe përdorur ambientet e shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh, c’ka perbën shkelje të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pikat 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor. Për këtë shkelje neni 172 i Kodit Zgjedhor parashikon sanksion administrativ në masën 100 000 deri 500 000 lekë.
- Pjesëmarrja e z. Blendi Klosi në këtë aktivitet, është në cilësinë e përfaqësuesit politik të Partisë “Socialiste të Shqipërisë”. Referuar vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në nenin 3, pika 2 e vijues deputeti nuk është subjekt i këtij vendimi.

Nr: 187

Data: 08.10.2024

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:
 - a) Zj. Haide Dhuli, Drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh në vlerën 4000 (katër mijë) lekë;
 - b) Z. Vangjel Tavo, kandidatit për bashkinë Himarë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Pushimin e hetimit administrativ për z. Blendi Klosi, përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës edhe nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet

M. Bardhi

M.Koja

A.Lamçe

M. Çelmeta

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Nr: 187

Data: 08.10.2024

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicioniin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”